



**Republika e Kosovës / Republic of Kosovo**  
**Komuna - Municipality**  
**Hani i Elezit**



**Nr. 02/767/2023**

**Data: 26.01.2024**

**RAPORT I DEBATIT PUBLIK MBI PLANIN E PUNËS SË KRYETARIT PËR  
VITIN 2024**

Njoftimi për debatin publik lidhur me Planin e Punës së Kryetarit për vitin 2024 u bë konform Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 68, Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr.03/2012 për Transparencë në Komuna, me datën 12.12.2023, i cili u publikua edhe në webfaqen e Komunës, në të cilin paraqitet data, ora dhe vendi i planifikuar për mbajtjen e debatit publik, pra me datën 26.12.2023 duke filluar nga ora 10:00 tek Qendra e Kulturës “Imri Curri” në Han të Elezit.

Për më tepër gjeni linkun e njoftimit për debatin publik: <https://kk.rks-gov.net/haniielezit/debat-publik-plani-i-punes-i-kryetarit-te-komunes-per-vitin-2024/>

Ashtu siç ishte përcaktuar edhe në njoftimin për debatin publik mbi Planin e Punës së Kryetarit për vitin 2024, debati publik u mbajt me datën 26.12.2023 duke filluar nga ora 10:00 te Salla e Konferencave te Qendra e Kulturës “Imri Curri” në Han të Elezit. Në këtë takim mori pjesë Kryetari i Komunës, Mehmet Ballazhi, i cili edhe e kryesoi debatin publik. Poashtu, pjesë e takimit ishin edhe Sevdi Dernjani (Nënkryetar i Komunës), Kimete Kuka-Hasallari (Drejtoreshë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale), Lindita Ballazhi (Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa), Majlinda Kaloshi (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik), Natyra Kalisi (Drejtoreshë e Administratës së Përgjithshme), Arsim Dernjani (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), Abduraman Bushi (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), Hisni Luri (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport) dhe Nexhmedin Daci (Drejtor përbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), si dhe nga Kabineti, zyrtarë të drejtorive përkatëse, si dhe qytetarë nga Hani i Elezit me rrethinë, ku gjithsej pjesëmarrës/e ishin 21 persona, prej tyre 7 gra dhe 14 burra.

Në këtë debat publik, Kryetari i Komunës – Mehmet Ballazhi përveç që e kryesoi takimin, ai gjithashtu e prezantoi në pika të shkurtra Planin e Punës për vitin 2024, ndërsa më pas kryesimin e debatit e mori Nënkryetari i Komunës Sevdi Dernjani.

Për detaje më të hollësishme, ndiqni linkun e procesverbalit të debatit publik: <https://kk.rks-gov.net/haniielezit/procesverbal-i-debatit-publik-mbi-planin-e-punes-se-kryetarit-per-vitin-2024/>

Pas prezentimit të Planit, pjesëmarrësit u drejtuan me pyetje/rekomandime, tek të cilat u përgjigjën nga ekzekutivi, ku gjithsej ishin: një propozim, një kërkesë dhe dy pyetje, si më poshtë:



			Buxhet dhe Financa	por në projekt buxhet janë të gjitha, ku edhe në webfaqen komunale janë të publikuara, si edhe në Ligjin e ri të Buxhetit që do të dalin në janar.
3	Resul Suma – asambleist në Kuvendin Komunal	Në lidhje me zbulimin, dekori e të tilla, është një shumë mjaft e vogël, a është gabim teknik apo ashtu është planifiku.	Sevdi Dernjani – Nënkyetar i Komunës	Është një kod buxhetor që DSHPE-ja e ka planifiku vetëm për me rujt kodin buxhetor.
4	Ziber Xhoni – drejtor në SHML Dardania”	E kam edhe një kërkesë, Zyra për Informim në komunë që është, është mirë që me ardh edhe nëpër shkolla për me marr foto dhe incizime, e shoh që pak rëndësi i është kushtu kësaj pjese, sepse janë bo shumë punë, sidomos në SHML Dardania , ku janë vendos shkallët emergjente, janë digjitalizu të gjitha klasat, në asnjë klasë nuk kemi projektor, etj, dhe do të ishte mirë me u dhanë si hapësirë publicitare edhe për juve , dhe jo vetëm te shkolla e mesme, por edhe te shkollat e tjera ku është bo një investim goxha i madh dhe e dimë se numri i nxënësve është në rënie e sipër, dhe pse jo edhe nxënësit e Gilloboçicës me i josh për me ardh në shkollat në Han të Elezit, ku përmes paraqitjes nga komuna, do t’i joshte infrastruktura ma e mirë e shkollave. Do të ishte mirë që Zyrën e Informimit me e angazhu ma tepër dhe me u bo një promovim i punëve dhe infastrukturës shkollore.	Sevdi Dernjani – Nënkyetar i Komunës	Zyra e Informimit në institucionin komunal shpeshherë has në vështirësi për mbulimin e aktiviteteve të Kryetarit, e jo më me dal jashta institucionit komunal. Por unë ju sugjeroj juve që të gjitha ato aktivitete që i realizoni në shkollat tuaja t’i dërgoni në komunë dhe nuk do të ishte problem që ne me i postu aktivitetet në faqet e komunës.